



HIGJIENA E LOPËVE DHE E MJELJES

Higjiena e Lopëve dhe e Mjeljes

Një mjet për përmirësimin e cilësisë së qumështit dhe efektshmërisë së fermës

Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbatja e tij është nën përgjegjësinë e projektit “Përmirësimi i performancës dhe cilësisë së shërbimit të ekstensionit publik në sektorin e blegtorisë (IPESA). Ky projekt është i financuar nga BE dhe i zbatuar nga kompania NIRAS IC Sp.z.o.o.. Përmbajtja e publikimit nuk pasqyron domosdoshmërisht mendimet e Bashkimit Evropian.

Ky manual është miratuar nga përfituesi i projektit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.



Publikuar nga Projekti **IPESA**

“Përmirësimi i performancës dhe cilësisë së shërbimit ekstensiv publik në sektorin blegtoral” - EuropeAid/136437/IH/SER/AL






This project is funded by
the European Union



IPESA Project



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

IMPROVEMENT OF THE PERFORMANCE AND QUALITY OF THE PUBLIC EXTENSION SERVICE IN THE LIVESTOCK SECTOR

Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është nën përgjegjësinë e projektit "Përmirësimi i performancës dhe cilësisë së shërbimit të ekstensionit publik në sektorin e blegtorisë (IPESA). Ky projekt është i financuar nga BE dhe i zbatuar nga kompania NIRAS IC Sp.z.o.o.. Përmbajtja e publikimit nuk pasqyron domosdoshmërisht mendimet e Bashkimit Evropian.

Ky manual është miratuar nga përfituesi i projektit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

'© -2019- Projekti IPESA - "Përmirësimi i performancës dhe cilësisë së shërbimit ekstensiv publik në sektorin blegtoral" Projekt i zbatuar nga NIRAS IC Sp. z o.o. Të gjithë të drejtat e rezervuara. Licencuar në kushtet e Bashkimit Evropian'.

NIRAS
Project implemented by
NIRAS IC Sp. z o.o

Ministry of Agriculture and Rural Development, Office 114
Sheshi Skënderbej 2, Tirana 1000, Albania
E-mail: info@ipesa-project.al

Tabela e përmbajtjes

1	Hyrje.....	6
2	Vëzhgimi rutinë i strukturave.....	7
3	Mastiti.....	10
4	Strehimi dhe vend-qëndrimet.....	11
5	Higjiena e lopës.....	12
6	Lëvizja.....	12
7	Mjelja.....	12
8	Pastrimi i gjinjve, dizinfektimi i thithave përpara mjeljes dhe dizinfektimi i thithave pas mjeljes.....	13
9	Numri i Qelizave Somatike.....	14
10	Ruajtja e qumështit.....	14
11	Shëndeti i kafshëve.....	14
12	Konkluzionet.....	14

Shtojca 1: Mastiti klinik dhe Mastiti nën-klinik.....	15
Shtojca 2: Testi Kalifornian i Mastitit (skanimi TKM).....	15
Shtojca 3: Mënyra Sesi Një Lopë Ngrihet Në Këmbë.....	15
Shtojca 4: Karta e Pikëzimit të Higjienës.....	16
Shtojca 5: Pikëzimi i lëvizjes.....	17
Shtojca 6: Procedura e Mjeljes Hap pas Hapi.....	18
Shtojca 7: Ligji Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe produkteve me bazë qumështin”.....	21

Higjiena e Lopëve dhe e Mjeljes

Një mjet për përmirësimin e cilësisë së qumështit dhe efektshmërisë së fermës




1 Hyrje

Në Shqipëri, shumica e prodhuesve të qumështit janë fermerë të vegjël, të cilët rreth gjysmën e prodhimit e kanë për përdorim vetjak (vetë konsum, ose për ushqyerjen e kafshëve) ndërsa pjesa tjetër e prodhimit të qumështit u dërgohet përpunuesve të qumështit, ose shitet drejt-përdrejtë te konsumatori. Produktet e qumështit përbëjnë një pjesë të rëndësishme të shportës së tryezës të familjes shqiptare.

Objektivi i kësaj broshure është të motivojë ekstensionistët shqiptarë për të mbështetur fermerët e prodhimit të qumështit, nga lopët, për të përmirësuar praktikën e menaxhimit të përditshëm të lopëve, dhe si rezultat të përmirësojnë cilësinë dhe higjienën e qumështit, me moton “higjienë më e mirë e qumështit për kontrollin e mastitit dhe përmirësimin e cilësisë së qumështit në fermat e lopëve të qumështit”.

Shumë fermerë ende nuk kanë informacion ose ndërgjegjësim në lidhje me standardet. Shumë fermerë të lopëve të qumështit nuk kanë depozita ftohëse për ruajtjen e qumështit, që është parakusht për përmbushjen e sigurisë së qumështit dhe standardeve të cilësisë. Shumica e fermerëve nuk e dinë se cilat institucione janë përgjegjëse për sigurinë e ushqimit, shëndetin e kafshëve ose kontrollin e standardeve të qëndrueshme.

Mirëqenia e lopëve varet kryesisht nga mënyra se si menaxhohen ato nga njerëzit. Një sërë faktorësh mund të ndikojnë në mirëqenien e tyre, duke përfshirë strehimin dhe shtrojen, hapësirën dhe mbipopullimin, kushtet e transportit, etj. Standardet e mira të higjienës kanë një rëndësi të madhe për cilësinë e qumështit dhe produkteve të tij, si dhe për prodhuesin, pasi çmimi i qumështit shpesh varet nga cilësia; qumështi me cilësi të dobët do të refuzohet. Kështu, ekstensionisti duhet të ndihmojë fermerin e lopëve të qumështit të ndërmarrë veprime për aktivitetet e tij/saj të menaxhimit të fermës së qumështit (strehimi, ushqyerja, mjelja dhe çështjet shëndetësore) për prodhimin e qumështit të pastër dhe higjienik. Konsumatori dëshiron një produkt të sigurt dhe përpunuesit i duhet qumësht me cilësi të mirë për përpunim.



Trajtimi i qumështit ndikon rrënjësisht në cilësinë e produktit përfundimtar. Gjithashtu, origjina e prodhimit konsiderohet si një faktor i rëndësishëm për shumicën e konsumatorëve shqiptarë.

Para fillimit të zbatimit të aktiviteteve në lidhje me përmirësimin e higjienës së stallës, lopëve, gjinjve dhe qumështit, gjatë procesit të mjeljes, ekstensionistët dhe fermerët duhet të diskutojnë për: (i) faktorët që ndikojnë në shfaqjen e mastitit klinik dhe nënklinik, (ii) njohuritë dhe informacionet e nevojshme për të përmirësuar shëndetin e gjinjve dhe parandalimin e mastitit, dhe më e rëndësishmja, (iii) si të ndërgjegjësohen fermerët për mënyrën e përmirësimit të shëndetit të gjinjve në fermat e lopëve të qumështit.

Për më tepër, gjëja e parë që duhet bërë për secilën fermë është plotësimi i një pyetësoi me qëllim mbledhjen e informacionit mbi nivelin e njohurive të fermerëve në lidhje me higjienën e qumështit, mastitit dhe sëmundjet e tjera, si dhe disa informacione të përgjithshme për prodhimin dhe mirëqenien e lopëve.

Vizita e ekstensionistit në një fermë qumështi duhet të fillojë me mjedisin e fermës. Menaxhimi i duhur i mjedisit përmirëson performancën e prodhimit të kafshëve, minimizon sëmundjet e kafshëve, dhe problemet me sjelljen e tyre. Lopët e qumështit mbarësohen në mjedise të larmishme, në të cilat mund të përshtaten me lehtësi. Mjediset e fermës përfshijnë të gjitha strukturat e strehimit, strukturat e mbajtjes së mjeteve të nevojshme, ndarjet, bokset, korridoret, si dhe oborret e parcelat pranë stallave ku mbahen kafshët për levizje, të çdo moshe dhe gjendje shëndetësore. Mjediset e fermës duhet të lejojnë lëvizjen e natyrshme të kafshëve dhe bashkëveprimin shoqëror të tyre. Mjediset duhet të sigurojnë mbrojtje të mjaftueshme nga temperaturat ekstreme Ushqimi dhe uji duhet të sigurohen brenda një zone që është e arritshme nga kafshët. Mjediset dhe strukturat e fermës nuk duhet të rrezikojë sigurinë dhe mirëqenien e kafshëve.



2. Vëzhgimi rutinë i strukturave përfshin monitorimin dhe ndërmarrjen e veprimeve për:



Kontrollin e shenjave që shfaqin kafshët: shihni, dëgjoni dhe prekeni lopën dhe gjykonin nëse ajo është e shëndetshme apo jo.

Mbajtjen pastër të stallave, oborreve, korridoreve, rethimeve dhe hyrjeve.

Pastërtinë e mjediseve dhe menaxhimin e mbetjeve.

Pastrimin e plehut.



Pjesët e ndërtesës ku kafshët nuk pranojnë të pushojnë ose flenë.

Të gjitha zonat e pushimit të kafshëve duhet të jenë me madhësi të mjaftueshme dhe duhet të mbahen të pastra dhe të thata.

Kontrollin e grazhdeve nëse janë të pastër dhe të rregullt.

Kontrollin për të parë nëse lopët po ripërtypen, një shenjë kjo e cila tregon se ato janë të rehatuara dhe të kënaqura.

Kontrollin e dysHEMEVE nëse janë të rrëshqitshme, duke përfshirë instalimin e vendkalimeve jo të rrëshqitshme.



Kontrollin nëse ka lagështi në sipërfaqe të forta të stallës. Ekspozimi ndaj patogjenëve mjedisorë ndodh kur lopët e qumështit janë në kontakt me lagështinë, baltën dhe plehun në stalla.

Kontrollin nëse shTROJA është e rehatshme dhe e pastër. Lopët duhet të kenë një vend të pastër e të thatë për t'u ulur.

Kontrolloni shëndetin e gjinjve.




Kontrolloni nëse lopët thahen ashtu siç duhet gjatë periudhës së laktacionit të vonë.

Kontrolloni nëse aplikohet terapia për lopët në periudhë tharje (Testi Kalifornian për Mastitin).



-Kontrolloni nëse ruhen të gjitha të dhënat për të gjitha trajtimet që kanë të bëjnë me infeksionin e mastitit.

-Kontrolloni qumështin e lopëve për anomali fizike/kimike/organoleptike.




Kontrolloni depozitat e ruajtjes së qumështit (bidonë, tanke ftohës), të cilat duhet të pastrohen dhe dizinfektohen pas çdo grumbullimi të qumështit dhe të mbahen në kushte të mira.



Kontrolloni sipërfaqet që kanë kontakt me qumështin, të cilat duhet të pastrohen dezinfektohen në mënyrën e duhur dhe të menjëhershme pas çdo mjeljeje. Të gjitha pajisjet duhen mbajtur pastër dhe në kushte të mira.

- Kontrolloni nëse ka mjaftueshëm ujë të pijshëm (ose ujë të pastër aty ku është e përshtatshme) në zonën e mjeljes për pastrimin e gjinjve, pajisjeve, duarve, dhe dysHEMEVE të pista gjatë dhe pas mjeljes.

Kontrolloni nëse janë ndërmarrë masat e duhura për kontrollin e insekteve, minjve dhe zogjve në ambientet e mjeljes për të shmangur kontaminimin.



Pajisjet e qumështit duhet të kontrollohen për nivelin e vakumit, frekuencën dhe raportin e pulsimit. Pajisjet portative duhet të pastrohen midis mjeljeve dhe mbetjet e mineraleve, yndyrës dhe proteinës të qumështit duhet të hiqen. Pastrimi efektiv bëhet me ujë të nxehtë, dezinfektues ose agjentë të tjerë kimikë. Neglizhimi për të larë pajisjet edhe një herë të vetme mund të bëjë që dërgesa e radhës e qumështit të refuzohet pas provave të cilësisë dhe për rrjedhojë të refuzohen edhe të gjithë dërgesat e qumështit.

Kafshët duhet të kenë akses në ushqim dhe ujë çdo ditë, në mënyrë të vazhdueshme, në një orar të rregullt, dhe sipas kërkesave të tyre specifike. Racionet duhet të sigurojnë ushqyesit e nevojshëm për mirëmbajtje, rritje, laktacion dhe mbarsje.




3. MASTITI

Mastiti është inflamacion i gjëndrës mamare që shoqërohet me infeksion bakterial. Shkaktohet nga mikroorganizma patogjenike të cilat hyjnë në gji nëpërmjet kanalit të thithave të gjirit, dhe dëmtojnë indet e thithave. Kjo shkakton përshkuershmëri të shtuar vaskulare, dhe ndryshon përbërjen e numrit të qelizave të qumështit dhe cilësinë e tyre.

Dy llojet e Mastitit janë:

Mastiti Klinik: Çdo tufë ka raste të mastitit. Kjo është një sëmundje që është gjithmonë e pranishme në ferma dhe shkakton problem serioze. Në rastin e mastitit klinik mund të shihen simptoma të dukshme si dhe një numër qelizash somatike (SCC) më e lartë. Mastiti u shkakton fermerëve humbje të mëdha financiare. Tri-dhjetë për qind e të gjitha rasteve me mastit ndodhin pa shfaqur simptoma të dukshme.

Mastiti sub(nën)-klinik: Ky lloj mastiti nuk shfaq shenja të dukshme infektimi, dhe është lloji më i zakonshëm (Shtojca 1). Për rrjedhojë, zbulimi arrihet më së miri duke ekzaminuar qumështin për numrin e qelizave somatike nëpërmjet Testit Kalifornian të Mastitit (TKM) ose me anë të një metode të automatizuar. Numri i qelizave somatike përputhet saktë me praninë e infeksionit. Lopët që kanë një sasi qelizash mbi 250,000 qeliza/ml kanë 80% më shumë gjasa të jenë të infektuara. Po kështu, sa më i lartë numri i qelizave në një depozitë të madhe qumështi, aq më shumë mundësi ka që të ketë infeksion në tufë. Suksesi për trajtimin e mastitit nënklinik varet kryesisht nga lloji i patogjenit dhe jetëgjatësia e infeksionit.



Testi Kalifornian i Mastitit (skanimi TKM) Si për mastitin klinik ashtu edhe për atë nënklinik duhet të aplikohet Testi Kalifornian i Mastitit (skanimi TKM). Skanimi TKM është shumë i dobishëm kur kemi të bëjmë me një lopë e cila ka një numër të lartë qelizash somatike (SOC), por që nuk shfaq ose shfaq fare pak simptoma të dukshme. Punonjësit dhe pronarët duhet të trajnohen për përdorimin në mënyrë të duhur të TKM (Shtojca 2).

Ne rekomandojmë gjerësisht që të gjithë fermerët e fermave të qumështit të fillojnë me regjistrimin e numrit të qelizave somatike të qumështit duke qenë se një numër i lartë qelizash somatike është shenjë e mastitit.

- ✓ Numër i ulët i qelizave somatike në qumësht do të thotë lopë të shëndetshme dhe të mirë menaxhuara.
- ✓ Numër i lartë i qelizave somatike zakonisht do të thotë se ka infeksion mastiti ose janë dëmtuar gjinjtë, gjë e cila shpeshherë ndodh për shkak të ndonjë makine mjelëse me defekt ose nga përdorimi i papërshtatshëm i pajisjeve të mjeljes.
- ✓ Në përgjithësi, lopët më të reja kanë SOC më të ulët.
- ✓ Ruani pajisjet tuaja të mjeljes në gjendje të mirë pune. Një makinë joefikase e mjeljes mund të shkaktojë numër të lartë të qelizave për shkak të dëmtimit të thithave dhe indeve të gjinjve. Sidoqoftë, një makinë efikase por që përdoret në mënyrë të gabuar mund të shkaktojë gjithashtu dëme.



Për të parandaluar dëmtimin e shëndetit të lopëve në përgjithësi dhe nga mastiti në veçanti, si dhe për të pasur qumësht të sigurt nevojiten të ndërmerren disa hapa, siç përshkruhet më poshtë:

4. Strehimi dhe vend-qëndrimet:

Strehimi i kafshëve duhet të jetë i thatë dhe i pastër për të ulur rrezikun e infeksionit në një fermë. DysHEMEJA duhet të jetë e pastër dhe e thatë sepse përndryshe lopët do përhapin jashtëqitjen në të gjithë stallën duke përfshirë edhe bokset.

Nëse vend-qëndrimet (bokset) e lopëve bëhen pis, ekziston një mundësi më e madhe e problemeve që lidhen me infeksionin e thithave, pasi mikroorganizmat kanë akses më të lehtë për të hyrë në kanalën e thithave. Rreziku i mastitit për sa i përket shtrojës, është i lidhur ngushtë me menaxhimin e vend-qëndrimeve (bokseve) të lopëve, mirëmbajtjen e gjinjve dhe mjedisin e përgjithshëm në stallë. Thelbësore është që një boks të mbahet i thatë dhe çdo lloj jashtëqitje ose shtroje e lagur të hiqet të paktën dy herë në ditë.



Për më tepër, është shumë e rëndësishme të vëzhgoni reagimet e lopëve në stallë. Shihni sesi lopët ngrihen dhe ulen në stalla. Lopët duhet të ngrihen në stallë në të njëjtën mënyrë siç do të bënin jashtë nëpër kullota. Lopët duhet të lëvizin kokën poshtë dhe përpara, në mënyrë që të mund ta zhvendosin peshën e tyre nga këmbët kur ata qëndrojnë. Në stalla, lopët mund të lëvizin përpara ose në anë. Normalisht rekomandohet që lopët të kenë të paktën 47 centimetra hapësirë për pjesën e kokës dhe 168 centimetra hapësirë për trupin e tyre. Për më tepër, duhet të sigurohet hapësira e shtrijës (të paktën 30 centimetra). Prandaj, vend-qëndrimi duhet të jetë i gjatë 245 centimetra përveç atyre rasteve kur lopët janë në gjendje të shtrihen në hapësirën e stallës - të tilla si në një stallë ku lopët janë përballë njëra tjetrës, në korridor ose jashtë stallës. Nëse një stallë nuk është afro 215 centimetra në gjatësi totale, ajo duhet t'i mundësojë lopës të shtrijet anash ndërkohë që ajo ngrihet (Shtojca 3).

Lopët kanë nevojë të ulen dhe reduktimi i kohës së qëndrimit ulur zvogëlon prodhimin e qumështit. Të qëndruarit ulur është e rëndësishme pasi vetëm atëherë lopa pushon, ripërthypet dhe gjithashtu thundrat e lopës çlodhen dhe thahen. Përveç kësaj, qarkullimi i gjakut përmes gjinjve rritet deri në 30 për qind. Në kushte ideale, lopët shtrihen përafërsisht 14 orë në ditë. Kur sipërfaqja e vend-qëndimit (bokseve) nuk është mjaftueshëm e rehatshme, lopët do të reduktojnë kohën e pushimit të tyre.

Nëse lopët nuk janë në gjendje të ulen kur të jetë e nevojshme, ata do të qëndrojnë në këmbë shumë gjatë dhe kjo do të ndryshojë ciklin e tyre natyror të sjelljes. Në raste të tilla, sapo lopët të ulen, ato do të qëndrojnë ashtu për një kohë të gjatë. Si rrjedhojë, lopët do të hanë dhe pinë më pak, do të shkojnë në zonën e ushqimit më rrallë dhe si pasojë do të konsumojnë më pak lëndë të thatë.

5. Higjiena e lopës

Për të pasur një përshtypje në lidhje me higjienën në fermë është e rëndësishme të gjykohet higjiena e tufës në përgjithësi. Një lopë e pastër është tregues i një ferme të pastër. Një lopë e pisët është tregues i një ferme të pisët. Ka tre pika vlerësimi për të gjykuar higjienën e një lope:



1. Gjintë

2. Pjesa e sipërme e këmbëve



3. Pjesa e poshtme e këmbëve/thundrat.



Fermerët duhen trajnuar që të kuptojnë si dhe pse lopët duhen pastruar çdo ditë ([shihni Shtojcën 4](#)).

6. Lëvizja

Bëni pikëzimin e nivelit të çalimit të lopët e fermës sipas një metode të standardizuar pikëzimi. Kjo do ju ndihmojë në evidentimin e problemeve potenciale përpara se një lopë të jetë dukshëm e çalë. ([shihni Shtojcën 5](#)).

7. Mjelja

Kontrolloni nëse ka një rutinë të rregullt për lopët, sidomos në kohën e mjeljes, e cila ndihmon në minimizimin e stresit. Mjelja është një aspekt i rëndësishëm sa i takon parandalimit të mastitit

Makina e mjeljes ka ndikim të madh në shëndetin e gjinjve. Faktorët që e bëjnë mjeljen e suksesshme janë një makinë mjelëse dhe teknikë mjeljeje e përshtatshme, si dhe lopë të pastra. Një pjesë e mirë e infeksionit të gjinjve shoqërohet me pasaktësi në mjelje. Gjatë mjeljes, patogjenët e mastitit jo vetëm transferohen, por gjithashtu hyjnë brenda në thithë. Shumë punëtorë mbartin stafilokok aureus në duart e tyre pa e ditur. Punëtorët duhet të mësohen të përdorin dorezat ose të paktën të lajnë mirë duart përpara se të fillojnë procesin e mjeljes.



¹ "Njerëzit duhet të tregohen të duruar. Lopët janë qenie që nuk logjikojnë. Mos harroni se kjo është "Shtëpia e Nënave". Trajtoni çdo lopë ashtu siç do trajtonit nënën. Dhënia e qumështit është veçori e mëmësisë: trajtimi i ashpër pakëson sekretimin e qumështit. Kjo më dëmtonte si mua ashtu edhe lopën. Gjithmonë mbajini mend këto ide kur merreni me gjedhin." W. D. Hoard – 1885, Hoard's Dairyman.

8. Pastrimi i gjinjve, dizinfektimi i thithave përpara mjeljes dhe dizinfektimi i thithave pas mjeljes

Gjinjtë mund të pastrohen me lecka letre ose lecka dizinfektuese njëpërdorimshe, ose me lecka pambuku. Rregulli standard është që përdoret maksimumi një leckë për lopë. Përrjashtim ka për lecat e pambukut që mund të përdoren për maksimumi 4 lopë. Leckat e pambukut duhen larë më ujë të nxehtë (85°C), në mënyrë që të asgjësojnë bakteret dhe të parandalohej transmetimi. Shumica e baktereve asgjësohen në 85°C.

Lopët që kanë mastit duhet të pastrohen me leckë më vete, e cila në asnjë mënyrë nuk duhet përdorur te lopët e tjera. Gjinjtë e pisët duhen pastruar me ujë të pastër dhe të thahen me lecka të pastra e të thata. Tharja, ashtu si higjiena, është gjithashtu e rëndësishme për teknikën e mjeljes.


Pastrimi i thithave përpara mjeljes ul numrin e infeksioneve të reja me patogenë mastiti. Fillimisht duhen hequr pjesët e ngurta/ashpëra, dhe më pas duhet bërë pastrimi/dizinfektimi i thithave.

Dizinfektimi i thithave ul rrezikun për infeksione të reja të gjinjve. Ngjyerja/spërkatja vret bakteret për rreth thithës. Përveç kësaj, dizinfektimi është i rëndësishëm për kujdesin e lëkurës së thithës. Patogjenët e mastitit kanë më pak mundësi shumimi në një lëkurë që është në kushte të mira. Është e rëndësishme që dezinfektuesi të mbulojë të paktën 2/3 e thithës, kështu që ngjyerja mund të jetë më efikase. Spërkatja duhet bërë në mënyrë shumë të përpiktë. Rekomandohet që menjëherë pas mjeljes lopëve të mos u lejohet të ulen pasi pikërisht në këtë moment kanalet e thithave janë të hapur dhe bëhet më e lehtë për bakteret që të kenë akses. Kanalet e thithave janë të hapura për rreth 20-30 minuta pas mjeljes. Të gjithë fermerët/punëtorët përgjegjës për mjeljen duhet të ndjekin një rutinë të qëndrueshme dhe të zbatojnë hapat e rekomanduara sipas radhës (Shtojca 6).

Koha e pritjes përpara montimit të makinës së mjeljes me gjinjtë: Është e rëndësishme që lopa 'ta lërë qumështin të rrjedh' përpara se makina mjelëse të montohet te gjinjtë. Koha optimale e pritjes është 60-90 sekonda pas kontaktit të parë me thithën.

Shkëputja e makinës mjelëse nga gjinjtë: Gjithmonë duhet parë nëse lopët janë mjelë plotësisht. Lopët që kanë ende qumësht (nuk janë mjelë plotësisht) kanë më tepër mundësi që t'u rrjedh qumështi në vend-qëndrime (bokse). Qumështi është një bazë ideale për ritjen e baktereve. Qumështi që rrjedh për pasojë mund të shtojë mundësinë për infektion të tufës. Nëse ka ndonjëherë dyshime se lopët nuk janë mjelë plotësisht, kontrolloni dhe shihni nëse është ky rasti apo jo.

Pastrimi i makinës mjelëse: Qumështi i mbetur në kupën thithëse dhe në makinën e mjeljes mund të transferojnë patogen mastiti nga njëra lopë te tjetra. Për të ulur rrezikun e transmetimit është e rëndësishme të pastrohet makina mjelëse dhe kupa thithëse pas mjeljes së lopës/lopëve me mastit dhe numër të lartë qelizash somatike.



Makina mjelëse dhe kupat thithëse duhen shplarë për 5 sekonda me ujë të nxehtë (85°C) në mënyrë që të kemi rezultatin më të mirë, pasi shumica e baktereve ngordhin në një mjedis prej 85°C.



Sipas dhjetëra autorëve, shumë faktorë, duke përfshirë moshën e lopës, numrin e pjelljeve, periudhën e laktacionit, muaji dhe stina e vitit mund të ndikojnë në SCC. Megjithatë, prania e patogjeneve në gjinj konsiderohet faktori kryesor përgjegjës për shtimin e qelizave somatike në qumësht. Për më tepër, mastiti në tufë duket se është i lidhur ngushtësisht me menaxhimin e tufës.



9. Numri i Qelizave Somatike

Sipas dhjetëra autorëve, shumë faktorë, duke përfshirë moshën e lopës, numrin e pjelljeve, periudhën e laktacionit, muaji dhe stina e vitit mund të ndikojnë në SCC. Megjithatë, prania e patogjeneve në gjinj konsiderohet faktori kryesor përgjegjës për shtimin e qelizave somatike në qumësht. Për më tepër, mastiti në tufë duket se është i lidhur ngushtësisht me menaxhimin e tufës.



10. Ruajtja e qumështit



11. Shëndeti i kafshëve

Sipas ligjit “Për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Qumështit dhe Produkteve me bazë Qumështin” (Nr. 9441, datë 11.11.2005) – Mjelja duhet bërë duke respektuar kushtet higjienike. Qumështi duhet të grumbullohet brenda dy orëve nga mjelja, të ftohet në temperaturën 8°C ose më ulët në rastet e grumbullimit të përditshëm, ose 6°C kur grumbullimi nuk është i përditshëm. Temperatura e qumështit të ftohur nuk duhet të kalojë 10°C kur transportohet për te përpunuesi, në rastet kur qumështi nuk grumbullohet brenda dy orëve nga mjelja (Shtojca 7). Për të arritur këto temperature, duhet përdorur një depozitë ftohje. Përndryshe cilësia e qumështit të papërpunuar nuk do të jetë e kënaqshme. sidomos në rastet e kushteve jo të mira higjienike gjatë mjeljes dhe transportit.

Shëndeti i gjedhit në një fermë qumështi është pjesë thelbësore e mbarështimit të mirë dhe e një programi mirëqenie. Një nga themelet për mirëqenien e kafshëve është të mos pasurit dhimbje, dëmtime dhe sëmundje. Sëmundja parandalohet duke zbatuar shëndetin e tufës, të ushqyerit e shëndetshëm, dhe programe menaxhimi që rrisin mirëqenien. Nëse sëmundja është e pranishme, menjëherë vihet në zbatim diagnostikimi dhe trajtimi. Një fermë qumështi ruan shëndetin e gjedhit duke mundësuar për të ushqimin e duhur, strehimin, parandalimin dhe pikasjen e sëmundjeve.



12. Konkluzionet

Nëse do të vihen në zbatim të gjitha hapat e lart përmendura për fermën, lopët, gjinjtë, higjienën e qumështit, dhe menaxhimin e procesit të mjeljes atëherë do të sigurohet cilësia e qumështit. Për më tepër, vlera e çmimit të qumështit do të rritet çka do të thotë cilësi më e mirë qumështi për konsumatorët dhe më tepër të ardhura për fermerët.

Shtojca 1


Mastiti klinik dhe Mastiti nën-klinik



➤ Burimi: Simon Dufour dhe Daniel Scholl (Përmirësimi i shëndetit të gjinjve në fermën tuaj Praktikat më të mira të menaxhimit)

Mastiti ka ndikim në fitimet e fermës

- Ndikon në 25-30 për qind të të gjithë pjesës së gjinjve.
- Sëmundja më e kushtueshme e lopëve të qumështit -Jo e dukshme për prodhuesit
- Shkuarja dëm e qumështit për shkak të trajtimit me antibiotik
- Kostot veterinare dhe mjekësore.
- Kostot e punës
- Therja e detyruar e lopëve



➤ Burimi: Këshilli Kombëtar i Mastitit, 1996, konceptet aktuale të Mastitit Bovin

Shtojca 2


Testi Kalifornian i Mastitit (skanimi TKM)

1. Shtrydhni 2 ose 3 currila qumështi nga secili gji në të katër kupat (mos përdorni currilin e parë të qumështit pasi ai gjithmonë ka më shumë qeliza)
2. Mbusheni secilën kupë në mënyrë të barabartë
3. Përzieni substancën së bashku me qumështin, dhe më pas trazojini për gjysmë minuti
4. Lëreni për 10 sekonda lëndën e përzier
5. Pas 10 sekondash është e mundur të dalloni trashjen e katër ekzemplarëve (trashje e dukshme ose trashje e menjëhershme, formimi i xhelit tregon që SCC janë 400,000 deri në 1,000,000 qeliza/ml qumësht)



Shtojca 3

Mënyra se si një lopë ngrihet në këmbë



➤ Burimi (përshtatur nga): Anon. Projektimi i strehimit për gjedhët, DACC.

Shtojca 4

Karta e Pikëzimit të Higjienës

Jo më tepër se 10 për qind e kafshëve duhet të kenë 3 ose më shumë pikë (1 është e pastër, 4 është e pisët).




Burimi: UHC- Instrument për analizën e higjienës së gjinjve (H. Borkent dhe I. J. Bos dhe M.M.L. Fleuren dhe Menno Middeldorp, 2013)

Shtojca 5: Pikëzimi i lëvizjes

1
Lopa mund të qëndroj dhe të ece normalisht
më të 4 këmbët.
Konsumi ushqimor: 0%
Rendimenti i qumështit 0%
Konkluzioni: OK




2
Lopa qëndron normalisht dhe ka tendencë të eci
e përkulur prapa. Koka është më shumë e ulur
se normalisht.
Konsumi ushqimor: -1 %
Rendimenti i qumështit: 0%
Konkluzioni: Kujdes



3
Lopa qëndron dhe ka tendencë të eci e përkulur
prapa. Koka është më e ulur se normalisht. Ecja
është pak anormale
Konsumi ushqimor: -3%
Rendimenti i qumështit: -5%
Konkluzioni: Trajtim efikas sa më shpejt të jetë e
mundur



4
Lopa qëndron dhe ka tendencë të eci e përkulur
prapa. Koka është më e ulur se
normalisht. Ajo bën një hap më të shkurtër me
një ose me më shumë këmbë.
Konsumi ushqimor: -7%
Rendimenti i qumështit: -17%
Konkluzioni: Vendoseni në ndarje të vecantë.
Trajtim efikas sa më shpejt të jetë e mundur



5
Lopa qëndron dhe ka tendencë të eci e përkulur
prapa. Koka është më e ulur se normalisht. Çalon
shumë me një ose me më shumë këmbë.
Konsumi ushqimor: -16%
Rendimenti i qumështit: -36%
Konkluzioni: Vendoseni në ndarje të vecantë. Lopa
është shumë e sëmurë. Ka nevoj për trajtim (bazuar
në ligj)



➤ Burimi: Manuali për Kujdesin e Kafshëve (www.nationaldairyfarm.com)

Shtojca 6

Procedura e mjeljes hap pas hapi

1. Higjiena e duarve.

- Duart duhen larë përpara procesit të mjeljes.



2. Dorezat.

- Duart e mjelësve janë të vështira për t'u larë, vishni doreza.
- Në doreza mbeten më pak baktere.



3. Currilat e para.

Currilat e para hidhini në një kovë të veçantë:

- për të shmangur përhapjen e mastitit që shkakton baktere në mjedis.
- për të dalluar shenjat e mastitit klinik.



4. Testi Kalifornian i Mastitit (TKM).

Përdorni rregullisht testin TKM për të zbuluar mastitin nën-klinik (p.sh. një herë në muaj). Testin TKM përdoreni specifikisht për:

- Pas një trajtimi të mastitit.
- Përpara periudhës së tharjes
- Në fillim të laktacionit
- Ulja e numrit të lartë të qelizave somatike (SCC) mund të kërkojë një kohë të gjatë kështu që në momentin që dalloni shenjë e parë kontaktoni menjëherë veterinarin e zonës



5. Para-larja/dezinfektimi

- Larja e thithave të gjirit me një solucion pastrues, dizinfektues dhe trajtues.
- Mos lagni gjinjtë, por përqendrohuni të thithat.
- E thënë thjesht, larja mund të përmirësojë në mënyrë dramatike rutinën tuaj të mjeljes.



6. Tharja

- Thani thithat e gjirit me një leckë letre për lopë, ose leckë pambuku për 3-4 lopë.
- Tregoni vëmendje të veçantë ndaj majës së thithës.



7. Qumësht

- Montoni menjëherë makinerinë mjelëse pas tharjes së thithave.




8. Pas-larja/dezinfektimi

- Menjëherë pas mjeljes aplikoni larje/dezinfektim efikas të thithave të gjirit.
- Zgjidhni një larës/dezinfektues për thithat me viskozitetin e duhur, trajtimin optimal dhe veçori dizinfektuese.




9. Dezinfektimi i kupave

- Lani ose spërkatni kupat e thithjes me një dizinfektant që vepron menjëherë.
- Hiqini në kohë kupat thithëse në mënyrë që të shmangni dëmtimin e thithave.




Procedurat e kohëzgjatjes së mjeljes



10. Pas mjeljes

- Mbajini në këmbë lopët për 30 minuta për të ulur rrezikun e infeksionit ndërkohë që kanali i thithës është i hapur.
- Mbajeni shtrojen TË THATË & TË PASTËR.



përpara mjeljes

gjatë dhe në përfundim të mjeljes

20-30 minuta pas mjeljes



↳ Burimi: Përshtatur nga: Rrjeti Kërkimor për Mastitin Bovin Kanadez (DFO_milk procedure english poster_PRO.pdf); Rrjeti për Mastitin (<http://ëëë.reseaumammite.org/tactic/en/step-by-step-milking-procedure/>); Simon Dufour dhe Daniel Scholl (Përmirësimi i shëndetit të gjinjve në fermën tuaj Praktikë më të mira të menaxhimit); Rutina e Duhur e Mjeljes = Kontrolli i Mastitit & Cilësia e qumështit (MILKING-ROUTINE.pdf).

Shtojca 7

Ligji Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe produkteve me bazë qumështin”.

Shtojca **A**

KËRKESAT PËR GRUMBULLIMIN E QUMËSHTIT TË PAPËRPUNUAR NË QËNDRAT E PËRPUNIMIT

KREU III KËRKESAT PËR MJELJEN GRUMBULLIMIN DHE TRANSPORTIN E QUMËSHTIT TË PAPËRPUNUAR NGA FERMA PRODHUESE NË QENDRAT E GRUMBULLIMIT, STANDARDIZIMIT OSE NË QENDRËN E PËRPUNIMIT. HIGJIE-NA E PERSONELIT

A.

Kërkesa për mjeljen. Mjelja të bëhet duke respektuar të gjitha kushtet higjienike, sipas dispozitave të ligjit “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”. Menjëherë pas mjeljes qumështi vihet në një vend të pastër, i cili është i tillë që shmang çdo ndikim negativ mbi cilësinë e qumështit. Nëse qumështi nuk grumbullohet brenda dy orëve nga mjelja, ai ftohet në temperaturën 8 gradë C apo më pak në rast të grumbullimeve ditore ose 6 gradë C kur grumbullimi nuk është ditore. Kur transportohet për në qendrën e trajtimit dhe/ose përpunimit temperatura e qumështit të ftohur nuk duhet t'i kalojë 10 gradë C, nëse qumështi nuk është grumbulluar brenda dy orëve nga mjelja.







Manuali është përgatitur nga ekipi i projektit IPESA:

Ylli Biçoku – Ekspert
Fatbardh Sallaku – Ekspert
Hrvoje Horvat – Ekspert Ndërkombetar
Morten Sejersen – Udhëheqësi ekipit
Jonida Naqellari – Menaxhere Zyre
Idlir Koka – Grafika